



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/18

Datë: 11.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 11 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumentit për Kompensimin e Viktimave të Krimin.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

**KONCEPT DOKUMENTI PËR KOMPENSIM TË VIKTIMAVE
TË KRIMIT**

Kapitulli 1: Hyrje

Në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, pjesa e Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2015, është paraparë që të hartohet Koncept - dokumenti për Kompensimin e Viktimave të Krimit, po ashtu kjo kërkohet edhe në kuadër të Planit të Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe objektivit të parë të Planit Zhvillimor Strategjik të MD-së për vitin 2012-2016.

Kjo çështje është prioritare, pasi që aktualisht funksionalizim i skemës për kompensim të viktimave të krimit nga shteti nuk është e rregulluar me dispozita të veçanta, përkundër faktit se është e paraparë me Kodin e Procedurës Penale, me legjislacionin e BE-së dhe Konventat Ndërkombëtare. Rregullimi i kësaj fushe ndihmon në krijimin e infrastrukturës së përgjithshme për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe njëkohësisht mundëson plotësimin e obligimit të shtetit për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare.

Rregullimi i kësaj fushe ndërlidhet me objektivin e dytë të Qeverisë, për sundimin e ligjit dhe shtetit të së drejtës.

Zotimi i Qeverisë, respektivisht i MD-së, është se kjo çështje do të rregullohet në pajtim me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke qenë se kjo çështje është njëherit edhe kërkesë që del nga përmbushja e kriterëve të përcaktuara për integrim evropian. Po ashtu, edhe në kuadër të programit katër vjeçar të Qeverisë.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Kjo fushë nuk është e mbuluar që nga pas lufta e deri më tani dhe si pasojë e mos rregullimit me legjislacion adekuat viktimat asnjëherë nuk janë kompensuar nga shteti për dëmin e shkaktuar, ndonëse ka ekzistuar Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 Mbi Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, si dhe Urdhëresa Administrative nr. 2005/3 mbi zbatimin e Rregullores së lartpërmendur, të cilat kanë paraparë krijimin e një programi për kompensim të viktimave të trafikimit, megjithatë këto dispozita asnjëherë nuk kanë gjet zbatim. Si legjislacion bazë që gjithashtu parasheh një skemë të kompensimit të viktimave nga shteti është edhe Kodi i Procedurës Penale në Nenin 1 (26), dhe neni 62 (1.5), si dhe Ligji Nr. 04/L-218, për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit neni 42, 43, dhe 44.

Përveç ndikimit negativ direkt në viktimat, mos funksionalizmi i një skeme të kompensimit nga shteti ka rezultuar edhe në raporte negative të Kosovës si shtet për shkak të mos përmbushjes së këtij obligimi që ka ndikuar në rangimin negativ të Kosovës në raportet e ndryshme vjetore të BE-së, State Departmentit të SHBA-së, e që

për pasojë mes tjerash mund të ketë ndikim në reduktimin e asistencës financiare për Kosovën si shtet në fushën e sundimit të ligjit.

Si pasojë e mos mbulimit të kësaj fushe ka rezultuar në riviktimizimin e viktimave, sidomos viktimave të ndjeshme, të cilat mund të jenë në varshmëri ekonomike nga kryesi, përfshirë viktimat e dhunës në familje, trafikimit me njerëz, abuzimi me fëmijë etj.

Më së shumti të ndikuar me mos funksionalizimin e skemës së kompensimit nga shtetit kanë qenë viktimat e ndjeshme sipas Kodit Penal të Kosovës, neni 120 (37). Të gjitha pjesët e Republikës së Kosovës janë të prekura. Skema e kompensimit nga shteti do të duhej funksionalizuar për kompensimin vetëm të individëve, e jo edhe kompensimin e organizatave si palë të dëmtuara.

| Përmasat dhe Kohëzgjatja e Problemit/Zotimit | | | | | | | | |
|--|--|--|------|------|------|------|------|--|
| | | | Viti | Viti | Viti | Viti | Viti | |
| Numri i njerëzve / incidenteve /organizatave | | | 2012 | 2013 | 2014 | | | |
| KGJK | | | | 907 | 1557 | | | |
| MPMS | | | 465 | 344 | 476 | | | |

Mbrojtësit e viktimave, të cilët i përfaqësojnë viktimat në procedurë kanë vështirësi në realizimin e të drejtave të viktimave, sipas tyre nuk ka pasur asnjë rast të kompensimit të viktimave, për shkak të mos mbështetjes nga ana e shtetit.

Politika aktuale

Aktualisht nuk ekzistojnë politika apo programe që mundësojnë kompensimin e viktimave nga ana e shtetit. I vetmi kompensim i paraparë është kompensimi nga i pandehuri, i cili edhe ashtu është vështirë i realizueshëm në shumë raste për shkak të prolongimit të procedurave gjyqësore dhe shpesh edhe për shkak të insolvencës së të pandehurve. Duhet theksuar, se përkundër kësaj, kompensimi nga shtetit, bazuar edhe në praktikat dhe standardet ndërkombëtare nuk do të paraqiste burim primar të kompensimit të viktimave, por do të ishte si një alternativë e fundit apo në disa raste edhe si alternativë emergjente për një kategori të caktuar të viktimave.

Meqë skema për kompensimin e viktimave nuk është funksionale, asnjë institucion nuk është përgjegjës për zbatimin e kësaj politike.

Në kuadër të mbështetjes për viktimat, deri më tani institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e ndryshme joqeveritare kanë ofruar shërbime të ndryshme për përkrahjen dhe riintegrimin e viktimave të krimit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes kontraktimit të shërbimeve sociale nga organizatat joqeveritare mundëson shërbimet e strehimit, riintegrimit dhe rehabilitimit të viktimave të trafikimit me njerëz, dhunës në familje dhe abuzimeve seksuale.

Ministria e Shëndetësisë, në bazë të Ligjit për Shëndetësi dhe sipas marrëveshjeve me Koalicionin e Strehimoreve të Kosovës dhe Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, ofron shërbime shëndetësore falas për viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe të mbijetuarve të torturës në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor. Ofrimi i këtyre shërbimeve bazohet në Udhërrëfyesin mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore.

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë ekziston Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje, ndërsa në Kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme ekziston Koordinatori Nacional kundër Trafikimit me Njerëz që bëjnë bashkërendimin e aktiviteteve të institucioneve dhe OJQ-ve, e që ofrojnë shërbime direkte këtyre kategorive.

Prokuroria e Shtetit, përmes Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, ofron shërbime të këshillimit dhe përfaqësimit ligjor për viktimat e dhunës në familje, trafikimit, dhunës seksuale, vrasjeve dhe grabitjes.

Agjencia për Ndihmë Juridike ofron shërbime juridike falas për viktimat e dhunës në familje me theks të veçantë në aspektet civile të mbrojtjes së kësaj kategorie.

Disa nga komunat e Republikës së Kosovës mbështesin organizatat joqeveritare, të cilat ofrojnë shërbimet e strehimit për viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit.

Mbështetjet që ofrojnë këto komuna nuk janë të rregulluara në mënyrë të unifikuar në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Përveç institucioneve shtetërore, ndihmë dhe strehim viktimave të dhunës në familje, trafikimit dhe abuzimeve seksuale u ofrohet në kuadër të strehimoreve të Kosovës, të cilat funksionojnë si organizata joqeveritare të mbështetura nga donacione të ndryshme.

Për rregullimin e çështjes së kompensimit të viktimave janë nxjerrë një sërë aktesh ligjore e nënligjore, të cilat në mënyrë indirekte i referohen kompensimit, mirëpo nuk ka pasur zbatim dhe funksionalizim praktik të kësaj fushe. Si pasojë e mosfunksionalizimit në praktikë të këtyre akteve përkatëse, nuk ka pasur kompensim të viktimave të krimit.

1. Ligjet dhe aktet nënligjore

Ligjet

Ligjet të cilat ndërlidhen me këtë çështje janë:

- Kodi Penal i Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
- Ligji i Buxhetit;
- Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Ligji për Shëndetësi 2004/4;
- Ligji për Sigurime Shëndetësore;
- Ligji mbi Familjen 2004/32;
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare 02/L-17;
- Ligji për Barazi Gjinore;
- Ligji për të Huaj 2008/03-L-126;
- Ligji për Azil 2008/03- L-066;
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048.

2. *Aktet nënligjore që ndërlidhen me këtë problem/çështje*

- Rregullorja e UNMIK-ut 2001/04, për Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë;
- Urdhëresa Administrative 2005/3, për zbatimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/04, për Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë.

Dokumentet tjera relevante:

- Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Programi Kombëtar Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit;
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore;
- Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje;
- Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit;
- Standardet Minimale të Kujdesit për Viktimat e Trafikimit;
- Udhërrëfyeni mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore.

Kodi Penal

Kodi Penal i Kosovës në nenin 64, urdhri për kompensimin e humbjes, apo dëmit –ku gjykata ia cakton urdhrin kryesit që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale, për të cilin kryesi është shpallur fajtor për veprën penale që përfshinë vjedhjen, humbjen, apo shkatërrimin e pasurisë që rezulton nga ajo vepër penale.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Në Nenin 1.26 definojnë Fondin për Kompensimin e Viktimave, si fond në të cilin depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzarisë dhe pasurive të tjera të autorizuara me ligj. Pagesat nga Programi për Kompensimin e Viktimave përdoren për kompensimin e viktimave të krimit siç caktohet me ligj.

Në nenin 62 të drejtat e të dëmtuarit; paragrafi 1.5, çështjen e kompensimit e cekë si në vijim: “nëse gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesës së kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata që të dërgojë urdhrin për kompensim tek Koordinatori i Fondit për Kompensimin e Viktimave”.

Ligji Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit

Ky ligj rregullon kompensimin nga shteti përmes këtyre neneve:

Neni 42 - Kompensimi nga Shteti

Neni 43 - Kompensimi i Viktimave Fëmijë, dhe

Neni 44 - Kërkesa për Kompensim nga Shteti.

Sipas këtyre neneve dhe dispozitave relevante në të njëjtin ligj, përcaktohet se në të gjitha rastet kur viktimat nuk mund të realizojë kërkesën për dëmshpërblim në procedurë penale dhe civile, atëherë e njëjta mund të parashtrijë kërkesë për kompensim nga shteti. Ky ligj nuk përcakton aspektet procedurale të parashtrimit të kërkesës, apo të drejtën në kompensim ose bën referencë se kjo çështje do të rregullohet me akt juridik përkatës për kompensimin e të gjitha viktimave të krimeve.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 për Ndalimin e Trafikimit me Njerëz në Kosovë, për herë të parë e definojnë trafikimin me njerëz si vepër penale në Kosovë dhe përmes Urdhërësës Administrative 2005/3 për zbatimin e kësaj rregulloreje e parashih formimin e Koordinatorit për Ndihmë Viktimave, i cili do të merrej edhe me formimin e Fondit për Kompensimin e Viktimave. Mirëpo, kjo urdhëresë nuk ka hasur asnjëherë në implementim.

Kodi i Procedurës Penale i referohet nenit 62, në të drejtat e të dëmtuarit, që në rastet kur dëmshpërblimi nuk mund të bëhet nga i pandehuri, atëherë viktimat të udhëzohet në kompensim tek Koordinatori i Fondit për Kompensim të Viktimave, i cili më pas definohet në Neni 1.26, si fond në të cilin depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzuar dhe pasurive tjera të autorizuara me ligj. Edhe pse Kodi e ka definuar sesi të rregullohet çështja e financimit të një programi të tillë, megjithatë sipas Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, një financim i tillë direkt siç është paraparë në këtë nen nuk është e lejuar, dhe për këtë kërkohet që të gjinden alternativa të tjera për funksionalizimin e këtij fondi.

Ligji i Shëndetësisë 04/L-125 me nenin 61, i parashihet kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruar nga bashkëpagesat : paragrafi 2.1-viktimat e trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar në pajtim me ligjin; paragrafi 2.5 - persona të zhvendosur me dhunë jashtë shtepive të tyre si viktimat e dhunës në familje, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pajtim me ligjin.

Ligji për Sigurime Shëndetësore 04/L-249, me nenin 11 parashihet të siguruarit e obliguar me paragrafin 2.6 për viktimat e trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar në pajtim me ligjin; me paragrafin 2.8 viktimat e dhunës në familje gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në pajtim me ligjin.

Siç është potencuar në pikat paraprake, fillimisht Kosova ka treguar një gatishmëri për rregullimin e kësaj çështjeje për kategorinë e viktimave të trafikimit bazuar në rregulloret e mëhershme në fuqi. Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale, Kosova ka bërë një hap përpara drejt njohjes dhe realizimit të drejtave të viktimave të krimit në përgjithësi. Në këtë frymë, ky kod për herë të parë ka paraparë edhe mundësinë e kompensimit nga shteti edhe për kategoritë e tjera të viktimave duke mos u kufizuar vetëm në viktimat e trafikimit. Duke qenë se Kosova është në proces të përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave dhe po ashtu nënshkrimit të MSA-së, është paraqitur nevoja që në pajtim me EU aquis çështja e kompensimit të viktimave të rregullohet me një akt të veçantë.

Mirëpo, mosfunksionalizimi i Fondit për Kompensimin e Viktimave deri më tani ka ardhur si rrjedhojë e kufizimeve buxhetore dhe mungesës së koordinimit ndërinstitucional.

Programi aktual

Aktualisht nuk ka asnjë program i cili në mënyrë të veçantë e adreson çështjen e kompensimit të viktimave. Të gjitha programet aktuale të listuara më lartë për viktimat e krimit janë strategji dhe plane të veprimit të cilat fokusohen në mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat e trafikimit me njerëz dhe viktimat e dhunës në familje, por asnjëra nga të mësipërmet nuk rregullon mënyrën e funksionalizimit të kompensimit nga shteti.

Duke qenë se Programi për Kompensimin e Viktimave ende nuk është i funksionalizuar, rrjedhimisht edhe nuk ka ndonjë financim të ndonjë agjencie apo organizate që lidhet direkt me çështjen e kompensimit të viktimave nga shteti.

Shpenzimet e paraqitura në tabelën e mëposhtme i referohen buxheteve të institucioneve përkatëse për ofrimin e shërbimeve tjera, vetëm për viktimat e disa prej kategorive, siç janë të listuar në tabelë. Asnjëra nga këto shërbime nuk ndërlidhen me kompensimin material të viktimave të këtyre kategorive.

Sa i përket financimit nga donatorët edhe kjo pjesë i referohet financimit të shërbimeve të ndryshme për viktimat e kategorive të ndryshme. Duke qenë se kryesisht këto donacione vijnë nga donatorët ndërkombëtarë është e pamundur të përcaktohet një shifër e saktë për fondet e dhuruara në këtë fushë.

| Kategoria e shpenzimeve | Shpenzimet faktike në vitin paraprak (2014) | Buxheti këtë vit | KASH për vitin e ardhshëm |
|---|---|------------------|---------------------------|
| Buxheti i Departamentit për Profesione të Lira në Ministrinë e Drejtësisë | 52,713.00 | 52,713.00 | 75,000.00 |
| Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale: (Buxheti për shërbimet e strehimit që i jepen strehimoreve të Kosovës për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit) | 183,747.00 | 183,747.00 | |
| Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (Buxheti i Zyrës ZMNV për shërbimet e këshillimit ligjor dhe përfaqësimit ligjor të viktimave të dhunës në familje, trafikimit, abuzimeve seksuale, vrasjeve, grabitjeve të cilat ofrohen përmes Mbrojtësve të Viktimave) | 247,513.63 | 247,513.63 | |
| Financimi nga donatorët | | | |

Siç edhe u potencua më lartë, Kodi i Procedurës Penale i referohet Fondit për Kompensimin e Viktimave si një fond ekzistues. Megjithatë, edhe në kohën e miratimit të kodit ky fond nuk ka qenë i funksionalizuar. Problematikë tjetër është edhe fakti se po e njëjta dispozitë e kodit thekson se në këtë fond depozitohen mjetet nga konfiskimi i dorëzarisë dhe pasurive tjera të autorizuara me ligj, gjë që bie në kundërshtim me dispozitat përkatëse buxhetore. Andaj qëllimi i kësaj politike është gjetja e një zgjidhjeje permanente për mënyrën e funksionalizimit dhe financimit të fondit të kompensimit të viktimave.

Bazuar në legjislacionin e BE-së që rregullon çështjen e kompensimit të viktimave nga shteti është obligim i shteteve të BE-së, e njëkohësisht edhe i shteteve tjera të rajonit me aspirata për integrim në BE që këtë çështje t'ia kenë të rregulluar me legjislacion vendor.

Të gjitha shtetet anëtare të BE-së, përmes legjislacionit vendor e kanë të rregulluar skemën e kompensimit të viktimave nga shteti, skema këto të cilat i'u janë në përputhje me standardet e parapara me Direktivën e Këshillit për Kompensimin e Viktimave të Krimin 2004/80 EC, direktiva për themelimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen, dhe mbrojtjen e viktimave të krimit 2012/29/EU, Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme, Direktiva Evropiane për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave të tyre 2011/36 UE, si dhe dokumente të tjera relevante të BE-së. Një qasje e tillë provokimë e BE-së, ka ardhur në shprehje në veçanti me Traktatin e Lisbonës dhe Programin e Stokholmit të cilat theks të veçantë i vejnë çështjes së mbrojtjes së viktimave. Përgjithësisht të gjitha shtete e BE-së skemën e kompensimit nga shteti e kanë të rregulluar me ligj të veçantë. Skemat e tilla në pajtim me Konventën Evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme, parashohin që si kategori e mbuluar me këto skema janë vetëm viktimat e krimeve të dhunshme të qëllimshme. Duhet pasur parasysh se në pajtim me Direktivën për themelimin e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen, dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, termi viktimë përfshinë edhe anëtarët e familjes së viktimave të vrarë.

Edhe shtete e rajonit janë në hap me zhvillimet e reja në BE në këtë fushë. Çështja e kompensimit në Slloveni dhe Kroaci është e rregulluar me ligj të veçantë. Gjatë vitit 2014 edhe Mali i Zi ka hartuar një draftligj të ngjashëm i cili pritet të hyj në fuqi.

Bullgaria si një vend i cili rishtazi i'u ka bashkangjitur BE-së, çështjen e kompensimit e ka të rregulluar në mënyrë më të kompletuar. Në Bullgari, kompensimi është e rregulluar në atë formë që fondet për skemën për kompensim vijnë nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë. Programi i kompensimit plotësohet me ndarje buxhetore vjetore, të cilat fonde në fund të vitit nuk skadojnë por barten në vitin pasues.

Në Kroaci, mjetet për zbatimin e Ligjit të Kompensimit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kroacisë respektivisht Ministria e Drejtësisë.

Ndërsa Mali i Zi, përmes Projektligjit të sapo hartuar për rregullimin e çështjes së kompensimit ka paraparë sigurimin e fondeve nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë të Malit të Zi.

Sllovenia, po ashtu e rregullon çështjen e kompensimit të viktimave të krimeve të dhunshme dhe vartësve të tyre. Financimi i Fondit të Kompensimit në këtë shtet është i rregulluar në atë mënyrë që fondet pjesërisht vijnë nga shitja e asetëve të paligjshme të konfiskuara. Ky fond menaxhohet nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Sllovenisë.

Duke pasur parasysh kufizimet sipas dispozitave buxhetore në Kosovë, një qasje e mundshme që mund të adoptojë Kosova për financimin e fondit të kompensimit do të ishte aplikimi i modelit të Suedisë dhe Bullgarisë sa i përket mënyrës së financimit të fondit për kompensim. Suedia parasheh që çdo kryes i veprës penale, i dënuar me aktgjykim, t'i shqiptohet gjoba e një shume të caktuar, e cila gjobë dedikohet për financimin e fondit të kompensimit të viktimave. Sa i përket kategorive të viktimave të mbuluar me legjislacionet e shteteve të rajonit dhe të BE-së, përgjithësisht ekziston një uniformitet në qasje i të gjitha këtyre shteteve dhe atë në pajtim me legjislacionin e EU aquis.

Secili shtet i BE-së ka një skemë kombëtare që garanton kompensim shtetëror për viktimat e krimeve të dhunshme dhe mundëson sigurimin e kompensimit për secilën viktimë, pa marrë parasysh se në cilin vend në BE bëhet viktimë e një krimi. Përmes nenit 2 të Direktivës së Këshillit për Kompensim të Viktimave të Krimin 2004/80 EC, kompensimi i paguhet nga autoriteti kompetent i shtetit anëtarë të BE-së në territorin e të cilit është kryer krimi. Edhe Kosova gjatë hartimit të akteve të veçanta ligjore që do të rregullojë këtë çështje, duhet të ketë parasysh edhe praktikën e shteteve të ndryshme të BE-së dhe të rajonit në trajtimin e viktimave të huaja, duke analizuar mundësinë e ofrimit të kompensimit të paktën për një kategori të kufizuar të viktimave të huaja të cilat identifikohen si viktimë brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Në përpjekje të rregullimit të çështjes së kompensimit të viktimave, Kosova duhet të ndërmerri hapa të nevojshme që në pajtim edhe me legjislacionin në fuqi, kompensimi i viktimave të rregullohet në atë mënyrë që fillimisht të kërkohet dëmshpërblim nga kryesi i veprës penale gjatë rrjedhës së procedurës penale, ndërkaq kompensimi nga shteti të merret si opsion i fundit, vetëm në ato raste kur kompensimi nuk mund të realizohet, apo nuk ka gjasa reale që të realizohet nga i njëjti. Kjo qasje është në pajtueshmëri edhe me nenin 16 të Direktivës për Themelimin e Standardeve minimale për të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimin 2012/29/EU.

Kapitulli 3: Synimet dhe Objektivat

Synimi i përgjithshëm i këtij dokumenti është krijimi i infrastrukturës së përgjithshme për një funksionim të sistemit të drejtësisë dhe kompensimit të viktimave të krimit. Një funksionim i kompensimit të viktimave në mënyrë të rregullt, i kontribuon edhe ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të viktimave të krimit. Synimi i propozimit të kësaj politike është krijimi i kushteve të përshtatshme për një sistem të mirëfilltë të drejtësisë, ku viktimat e krimit mbështeten në aspektin financiar.

Nuk ka bazë ligjore e cila e përcakton mënyrën e rregullimit të kompensimit të viktimave të krimit, dhe si rrjedhojë nuk ka pasur kompensim të viktimave deri më tani. Andaj, përmes plotësimit të kësaj zbrazëtire ligjore, synohet të ndryshohet qasja për realizimin e së drejtës së kompensimit të viktimave përmes përcaktimit të mënyrës së funksionalizimit të kompensimit të viktimave.

Përmes kësaj politike do të realizohet e drejta e kompensimit të viktimave të krimit. Kjo e drejtë mund të matet përmes realizimit të kërkesave të parashtruara për kompensim nga ana e viktimave të krimit në periudha të ndryshme kohore. Deri më tani asnjë viktimë e krimit nuk është kompensuar, dhe me rregullimin e kësaj çështjeje do të mundësohet ofrimi i kompensimit të viktimave të atyre kategorive që do të kenë të drejtën për kompensim.

Rregullimi i çështjes së kompensimit të viktimave të krimit, i referohet krijimit të infrastrukturës së përgjithshme për një funksionim të sistemit të drejtësisë dhe kompensimin e viktimave të krimeve. Një funksionim i kompensimit të viktimave në mënyrë të rregullt, i kontribuon ndërtimit të shtetit të së drejtës dhe respektimit të viktimave të krimit. Rregullimi i kësaj çështjeje ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë, pasi Qeveria në fokus ka ndërtimin e një shteti funksional, të së drejtës përmes hartimit të infrastrukturës ligjore, dhe ku viktimat e krimit mbështeten nga shteti në çdo aspekt, e edhe në atë material. Prandaj, krijimi i bazës së mirë ligjore që i referohet respektimit të drejtave të viktimave dhe kompensimit është në harmoni të plotë edhe me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në kuadër të mandatit të Ministrisë së Drejtësisë, është krijimi i infrastrukturës dhe kushteve të përshtatshme për një sistem të mirëfilltë të drejtësisë, ku viktimat e krimit mbështeten në aspektin financiar.

Kjo politikë e Qeverisë së Kosovës është e arritshme pasi që me shumë akte ndërkombëtare dhe vendore njihet e drejta e viktimës për kompensim. Kosova ka një infrastrukturë ligjore e cila i referohet drejtës për kompensim të viktimave përmes legjislacionit përkatës siç është Kodi i Procedurës Penale, i cili i referohet Fondit të Kompensimit dhe po ashtu dispozitat tjera ligjore, por të cilat nuk e përcaktojnë mënyrën e rregullimit të kësaj çështjeje. Përmes kësaj politike do të arrihet të plotësohen zbrazëtitat ekzistuese ligjore në mënyrë që të funksionalizohet çështja e kompensimit të viktimave.

Në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, respektivisht të Ministrisë së Drejtësisë, parashikohet që ky objektivi të mund të arrihet brenda vitit 2015, më së largu deri në qershor të këtij viti. Mirëpo, për shkak që ky objektivi ndërlidhet edhe me kërkesat për liberalizimin e vizave ekziston një përkushtim që kjo çështje të kryhet sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni *status quo* (asnjë ndryshim)

Asnjë prej dispozitave aktuale nuk e rregullon në detaje mënyrë e funksionalizimit të Fondit të Kompensimit. Mos ndryshim i politikave aktuale do të rezultojnë në mos funksionalizimin e Fondit për Kompensim të Viktimave të Krimit nga ana e shtetit. Rrjedhimisht, edhe dispozitat në fuqi që adresojnë këtë çështje nuk do të mund të gjejnë zbatim praktik. Njëkohësisht, Kosova do të dështonte në përpjekjet e saj për harmonizimin e praktikave me shtetet e rajonit dhe shtete anëtare të BE-së, e që do të ndikonte në vlerësimin negativ në procesin e integritimit evropian dhe të anëtarësimit në Këshillin e Evropës.

Duke qenë se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 53, parasheh se liritë dhe të drejtat e njeriut interpretohen në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, atëherë me ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kosova rrezikon që të gjendet në shkeljen e obligimit pozitiv për mbrojtjen e të drejtave të viktimave dhe rrjedhimisht do të paguante kosto të lartë për mos ofrimin e mundësisë për realizimin e të drejtave viktimave. Mungesa e një mbështetje financiare, sidomos për viktimat e dhunës në varshmëri nga kryesit, bënë që të njëjtat si të vetmen zgjidhje të gjejnë kthimin tek abuzuesit e tyre, e kësaj radhe edhe me një formë të "pëlqimit të heshtur" nga shteti, kjo për faktin se shteti nuk ka gjetur mënyrë për t'i pavarësuar ato nga abuzuesit.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Opsioni 2- Ligji i veçantë për krijimin e programit për kompensimin e viktimave të krimit.

Rregullimi i çështjes për kompensimin e viktimave nga shteti mund të bëhet duke hartuar një politikë të re, respektivisht një ligji të ri, përmes të cilit do të përcaktoheshin qartë procedurat e funksionalizimit të një programi të kompensimit të viktimave të krimit.

Qëllimi i këtij ligji do të ishte funksionalizimi i Programit për Kompensim të Viktimave të Krimit. Ky Ligj do të përcaktonte kategorinë e viktimave që do të mund të kenë qasje në kompensim nga shteti në pajtim me praktikën më të mira dhe duke pasur parasysh edhe kufizimet sipas dispozitave buxhetore të vendit. Ligji njëkohësisht do të duhej të rregullonte edhe pjesën procedurale mbi mënyrën e parashtrimit të kërkesës, kushtet e pranueshmërisë, apo mospranueshmërisë së kërkesës, si dhe kategorinë e dëmtimeve mund të mbulohen. Po ashtu, në pajtim me Direktivën e Këshillit 2004/80/EC të 29 prillit 2004, lidhur me kompensimin e viktimave të krimit, ky ligj do të përcaktonte autoritetet kompetente dhe procedurat përkatëse. Bazuar në praktikën më të mira të shteteve të rajonit të përmendura më herët përgjatë këtij dokumenti, ky ligj do të përcaktonte në detaje formimin e komisionit për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjatë punës në këtë ligj, përveç praktikave të shteteve tjera dhe standardeve ndërkombëtare do të duhej konsultuar edhe i tërë legjislacioni vendor për t'u siguruar që të ketë harmoni mes dispozitave relevante që gjithashtu prekin këtë çështje, sidomos aspektit financiar të mbulimit të një skeme të tillë të kompensimit. Lidhur me këtë çështje përsëri mund t'i referohemi praktikave më të mira të shteteve të rajonit, të cilat mund të merren si shembuj më të aplikueshëm edhe për rregullimin e funksionalizimit të kompensimit në vendin tonë. Si shembuj të ndryshëm për mënyrën e financimit mund të përmendet p.sh. Ligji i Kroacisë për Kompensimin e Viktimave, i cili parasheh financimin nga Buxheti i Qeverisë si pjesë e alokimeve vjetore buxhetore. Për të mundësuar një alokim të tillë do të mund të përdoret edhe shembulli i Suedisë, sipas të cilit gjykata ngarkon secilin kryes të veprave penale të shpallur fajtor me aktgjykim dënues pagesën e një takse të caktuar, e cila taksë dedikohet për të financuar Fondin e Kompensimit. Për dallim nga shembulli i Suedisë, duke pasur parasysh se Kosova ka një buxhetit unik, në vend se këto të hyra të derdhen direkt në programin për kompensim, të njëjtat do të derdreshin në buxhetin e Kosovës.

Programi për kompensimin e viktimave mund të financohet edhe për mes kontributeve vullnetare dhe donacioneve private në pajtim me Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar.

Gjatë procesit të rregullt buxhetor të përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria - Ministria e Drejtësisë do të bënte një kërkesë

buxhetore për të financuar një linjë buxhetore për Programin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, në kuadër të Departamentit për Profesione të Lira. Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë do të kishte parasysh projeksionet për të hyrat e pritura. Ndarjet e para buxhetore për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, do të mund të bëheshin përmes procesit të parë buxhetor pasues pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Do të ketë nevojë për trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me vetëdijesimin e opinionit profesionistë për zbatimin e këtij ligji. Trajnime të tilla të specializuara do të ofrohen nga Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe organizatat të tjera donatore ndërkombëtare. Pas hyrjes së ligjit në fuqi, do të duhej të realizoheshin edhe fushata vetëdijësuese në opinion e gjerë për të informuar kategoritë e ndryshme të viktimave të krimit të cilat do të mund të parashtronin kërkesën për realizimin e drejtave të tyre për kompensim. Prokuroria, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës paraqesin disa nga autoritetet të cilat mund të angazhohen në realizimin e këtyre e fushatave.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit

Rregullimi i çështjes së kompensimit të viktimave të krimit mund të bëhet edhe përmes nxjerrjes së akteve nënligjore në institucionet që janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve ekzistuese që i referohen të drejtës së viktimave për kompensim. Kjo do të mund të realizohej në kuadër të legjislacionit ekzistues të cekur më lartë, e që rrjedhimisht, kjo do të nënkupton realizimin e së drejtës për kompensim vetëm të kategorive të caktuara siç janë viktimat e trafikimit. Gjegjësisht, një kompensim i tillë i kufizuar në kategori do të paraqitej edhe si diskriminues ndaj disa kategorive tjera të viktimave të krimeve të dhunshme. Me këtë Kosova nuk do të përmbushte në mënyrë të plotës obligimin shtetëror për trajtim të barabartë të viktimave të dhunshme, në veçanti viktimat të cilat kanë shtrirje më të madhe në vendin tonë.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

| Përmbledhje e Opsioneve | | | |
|--------------------------------------|------------------|------------------|--|
| Karakteristikat kryesore | Opsioni 1 | Opsioni 2 | Opsioni 3 |
| Karakteristikat kryesore të opsionit | Status Quo | Ligji i veçantë | Ndryshimi i zbatimit përmes akteve nënligjore sipas ligjeve ekzistuese , |

| | | | |
|---|--|--|--|
| | | | krijimi i fondit duke ndarë mjete nga buxheti i miratuar nga MD; MPB;MPMS, PSH, KGJK dhe Qeveria nga fondi rezervë |
| Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar | Viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe viktimat e krimeve seksuale | Viktimat e krimeve të dhunshme të qëllimshme | Kategori e kufizuar sipas ligjeve ekzistuese: viktimat e trafikimit me njerëz |
| Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët | Prokuroria e Shtetit, ZMNV, MD, MPMS, MPB dhe OJQ-të. | Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, dhe shoqëria civile. | Prokuroria e Shtetit, ZMNV, MD, MPMS, MPB dhe OJQ-të. |
| Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit | Këto institucione ofrojnë shërbime direkte të caktuara sociale, strehim, përfaqësim ligjor dhe programe të riintegritimit për viktimat e kategorive të caktuara të krimit. | Zbatimi i programit për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme të qëllimshme. | Zbatimi i kompensimit përmes akteve nënligjore në mënyrë të pjesërishme për një kategori të caktuar të viktimave. |
| Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi | Ligjet ekzistuese siç janë Kodi i Procedurës Penale, Ligji për | Ligji i ri për krijimin e programit për kompensimin e | Ligjet ekzistuese, siç janë Kodi i Procedurës Penale, Ligji për |

| | | | |
|---|--|---|---|
| dhe dënimet | Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave | viktimave të krimeve të dhunshme të qëllimshme. | Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave |
| Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat | Nuk ka ndryshim | Janë parashikuar taksat me rastin e shqiptimit të vendimeve të gjykatave dhe atë : a).10.00 € për kundërvajtje, b). 30.00 € Vepra Penale, dhe c). 50.00 € vepra të rënda penale, dhe të hyrat derdhen në Buxhetin e Shtetit. | Kjo mund të rregullohet nga institucioni përgjegjës që do t'i nxjerrë aktet e caktuara nënligjore |
| Fushatat e edukimit dhe komunikimit | Nuk ka ndryshim | Janë paraparë fushata për vetëdijesimin viktimave të krimit dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit | Nuk ka ndryshim |
| Udhëzimet dhe kodet | Nuk është paraparë | Do të hartohen udhëzime për parashtrimin e kërkesës për kompensim | Nuk është paraparë |
| Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni | Është e aplikueshme politika aktuale | Miratimi i ligjit të ri gjatë vitit 2015 | Aplikimi i politikave aktuale, institucionet përgjegjëse përcaktojnë afatin për hyrjen |

| | | | |
|--|--|--|-------------------------------|
| | | | në fuqi të akteve nënligjore. |
|--|--|--|-------------------------------|

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Megjithëse nuk është e mundur që të vlerësohen me siguri përfitimet, pasojat negative dhe kostoja e opsioneve, përmes analizës së informatave në dispozicion dhe konsultimit me grupet e prekura, është e mundur që të krijohet pasqyra më e mirë e saktë.

Përfitimet

Me Opsionin e mos ndryshimit të politikës aktuale do të mbetet edhe më tutje një gjendje e rëndë e mospërkrahjes së kësaj kategorie të popullatës së ndjeshme. Me dispozitat aktuale të cilat nuk e rregullojnë në detaje mënyrën e funksionalizimit të programit të kompensimit, do të pamundësohet realizmi i së drejtës së viktimave për kompensim nga ana e shtetit. Njëkohësisht, Kosova do të dështonte në përpjekjet e saj për harmonizimin e praktikave me shtetet e rajonit dhe shtete anëtare të BE-së e që do të ndikonte në vlerësimin negativ në procesin e integrimit evropian dhe të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Rregullimi i kësaj çështjeje është paraparë edhe në kuadër të kritereve të planit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian.

1. Përfitimet e opsionit 2.

Përmes opsionit të dytë do të arrihet rregullimi i kësaj çështjeje duke hartuar një politikë të re, respektivisht nxjerrja e një ligji të ri, përmes të cilit do të përcaktoheshin qartë procedurat e funksionalizimit të një programi të kompensimit të viktimave të krimit të dhunshëm të qëllimshëm nga shteti. Qëllimi i këtij opsioni do të ishte krijimi i bazës së mirë ligjore që i referohet respektimit të drejtave të viktimave dhe kompensimit të tyre nga shteti dhe ky opsion do të kontribuonte përmbushjes së kritereve të përcaktuara në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe të liberalizimit të vizave.

2. Përfitimet e opsionit 3.

Opsioni i tretë i referohet rregullimit të çështjes së kompensimit të viktimave duke nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e ligjeve ekzistuese që i referohen të drejtës së viktimave për kompensim. Legjislacioni ekzistues pjesërisht e rregullon çështjen e kompensimit për kategoritë e caktuara të viktimave të krimit. Përmes këtij opsioni nuk do të realizohet kompensimi i të gjitha viktimave të krimeve të dhunshme të qëllimshme, të cilat janë kategoria më ndjeshme e popullatës. Ky opsion nuk do të zgjidhte rregullimin e plotë të problematikës së kompensimit nga shteti.

Pasojat negative

Opsionit 1, (*status quo*), gjegjësisht mbetja në fuqi e legjislacionit dhe programeve aktuale, do të ketë pasoja negative, pasi që do të vazhdonte zbatimin joefikas të legjislacionit që nuk e rregullon këtë çështje dhe nuk i përgjigjet nevojave aktuale për realizimin e së drejtës së viktimave të krimit për kompensim nga shteti. Për më shumë ky opsion nuk është koherent me procesin e integritetit evropian, gjegjësisht me legjislacionin në fuqi.

Opsioni 3, pasojat negative të këtij opsioni janë vështirësia e implementimit të mënyrave të tjera të zbatimit që do të ndikonte në mënyrë direkte në vazhdimin e zbatimit jo efikas të ligjit dhe përfrimi i munguar i legjislacionit nga fusha e kompensimit të viktimave me *Acquis* e BE-së.

Kosto

Secili opsion do të ketë koston e tij. Përfshini një tabelë e cila përshkruan koston e përafërt të secilit opsion. Një tabelë përmbledhëse është dhënë më poshtë. Të gjitha ministritë duhet të respektojnë udhëzimet përkatëse të nxjerra nga Ministria e Financave, në pajtim me nenin 31 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.

| Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar | | | | |
|---|-----------------------------|------------------|------------------|------------------|
| | (Euro) | | | |
| | Viti aktual 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | Viti 2018 |
| Opsioni 1 | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Financimi i pritur nga donatorët | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Opsioni 2 | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e | 0.00 | 550,000.00 | 550,000.00 | 550,000.00 |

| | | | | |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| shpenzimeve | | | | |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave (më shumë të hyra) | 3,236,710.00 | 3,166,710.00 | 3,046,710.00 | 3,046,710.00 |
| Financimi i pritur nga donatorët | | | | |
| Opsioni 3 | | | | |
| Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve | 300,000.00 | 300,000.00 | 300,000.00 | 300,000.00 |
| Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave | | | | |
| Financimi i pritur nga donatorët | | | | |

Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së lartpërmendur konsultimet janë realizuar konsultime me ekspert të ndryshëm të specializuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të viktimave.

Konsultimet janë bërë me Prokurorinë e Shtetit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Financave, Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Shëndetësisë, Ambasadën Amerikane në Kosovë dhe organizatat joqeveritare. Qëndrimi i këtyre institucioneve ishte i përbashkët sa i përket ndryshimit të qasjes aktuale për rregullimin e çështjes së kompensimit të viktimave nga shteti. Përfaqësues të institucioneve të lartpërmendura kanë marrë pjesë në hartimin e këtij koncept dokumenti duke kontribuar në vlerësimin e problematikës dhe në formulimin e opsioneve për këtë fushë.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1, *status quo* (asnjë ndryshim), sipas vlerësimit do të vazhdonte të mundësonte vazhdimin e pasojave negative, meqenëse do të vazhdohej me zbatimin joefikas të legjislacionit aktual në fuqi.

Opsioni 2, miratimi i ligjit të ri do të mundësonte rregullimin adekuat të fushës së lartpërmendur si dhe do të mundësonte përafrimin e legjislacionit në këtë fushë me atë të *Acquis së* BE-së. Miratimi i ligjit të ri që do të rregullonte funksionalizimin e fushës së kompensimit të viktimave të krimit nga shteti, dhe është opsioni adekuat për arritjen e këtyre synimeve dhe objektivave.

Opsioni 3, apo nxjerrja e udhëzimeve të brendshme nuk do të aplikohet në praktikë, meqenëse ashtu siç është cekur më lartë, legjislacioni aktual bën zgjidhje të pjesërishme të kësaj problematike vetëm për një kategori të caktuar të viktimave dhe nuk është në pajtim me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në këtë fushë. Pasojë kryesore negative do të jetë e ngjashme me opsionin 1.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandimi i Ministrisë së Drejtësisë është që koncepti dokumenti të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim që sa më parë të evitohen vështirësitë dhe pengesat që janë paraqitur gjatë zbatimit në praktikë të legjislacionin aktual lidhur me rregullimin e çështjes së kompensimit të viktimave. Opsioni i rekomanduar në këtë koncept dokument është opsioni 2 për hartimin e ligjit të veçantë për kompensimin e viktimave të krimit. Në rast të miratimit të këtij koncepti dokumenti, Ministria e Drejtësisë do të fillojë hartimin e ligjit të veçantë, të cilin do ta dërgoj në Qeveri për procedim të mëtejshëm.

Kapitulli 10: Komunikimi

Ministria e Drejtësisë do të jetë e përqendruar në ofrimin e informacioneve lidhur me detajet e procesit të hartimit të Projektligjit, ku do të merren parasysh konsultimet me ekspertët në fushën e caktuar, si dhe konsultimi me shoqërinë civile të cilët punojnë në fushën e mbrojtjes së drejtave të viktimave. Komente kemi pasur vetëm nga ZKM, SKQ, të cilat janë inkuorporuar.

Format e komunikimit kanë qenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, grupet punuese për çka komunikimi ka qenë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.